

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9780, DATË 16.7.2007, “PËR INSPEKTIMIN DHE MBROJTJEN E TERRITORIT NGA NDËRTIMET E KUNDËRLIGJSHME” TË NDRYSHUAR”

I.QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i projektligjit lidhet me përfundimin e reformës së nisur në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, si dhe me forcimin e mekanizmave të kontrollit, disiplinimit të punimeve të ndërtimit dhe inspektimit të mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e kundërligjshme. Në këtë kuadër, projektligji synon të garantojë ushtrimin e veprimtarive ndërtimore dhe të aktiviteteve të tjera territoriale në përputhje me lejet e miratuara dhe me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Objektivi kryesor është krijimi i një strukture të vetme kontrolli dhe inspektimi, në nivel qendror dhe me degë rajonale, e cila të ushtrojë funksionet e kontrollit dhe inspektimit të territorit.

Projektligji synon ngritjen e një sistemi modern, efikas dhe të integruar inspektimi, i cili përfshin jo vetëm aspektet e kontrollit të zhvillimit të territorit, por edhe ato që lidhen me mjedisin dhe administrimin e fondit pyjor. Ky harmonizim lidhet ngushtësisht me kërkesat e Ligjit nr. 99/2024 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, duke siguruar përputhshmëri të plotë ndërmjet dispozitave sektoriale dhe kuadrit të përgjithshëm inspektues.

Nëpërmjet ndryshimeve të propozuara synohet arritja e disa objektivave kryesore:

- Riorganizimi i strukturave vendore të mbikëqyrjes së territorit dhe krijimi i një strukture të vetme për inspektimin, me qëllim rritjen e koherencës institucionale dhe shmangien e fragmentimit të kompetencave;

- Rritja e efikasitetit, llogaridhënies dhe transparencës së proceseve inspektuese, në funksion të forcimit të shtetit ligjor dhe mbrojtjes së interesit publik;
- Harmonizimi i kuadrit ligjor me legjislacionin në fuqi për inspektimin dhe me praktikën bashkëkohore të administrimit publik;
- Garantimi i vazhdimësisë operacionale, nëpërmjet përcaktimit të mekanizmave të qartë organizativë, funksionalë dhe proceduralë.

Këto objektiva, të ndërlidhura ndërmjet tyre, përbëjnë bazën për një sistem inspektimi të integruar, të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm, i cili rrit kapacitetet shtetërore për mbrojtjen e territorit, siguron respektimin e ligjit dhe shërben si instrument thelbësor për zhvillim të rregullt dhe të kontrolluar.

II.VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektakti nuk është i parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2025.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHMERITË

Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, ka për qëllim garantimin e respektimit të normave, standardeve dhe kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit në shkallë kombëtare, si dhe mbrojtjen efektive të territorit nga ndërtimet të paligjshme. Ky ligj, së bashku me paketën e akteve ligjore dhe nënligjore që e plotësojnë, përbën bazën themelore për sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të territorit. Megjithatë, pavarësisht ndryshimeve të kryera ndër vite, praktika ka treguar se fenomeni i ndërtimeve në kundërshtim me legjislacionin vijon të jetë i pranishëm, kryesisht për shkak të mungesës së një kontrolli efektiv dhe të unifikuar në të gjithë vendin nga autoritetet përgjegjëse.

Ligji nr. 9780, i ndryshuar, parashikon ushtrimin e funksioneve të kontrollit dhe inspektimit nëpërmjet Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) dhe inspektorateve të mbrojtjes së territorit pranë njësive të vetëqeverisjes

vendore. Krijimi i dy niveleve të veçanta kontrolli ka çuar në fragmentim institucional, mospërputhje të praktikave dhe mungesë uniformiteti në zbatimin e ligjit, duke mos arritur objektivin për një mbikëqyrje efektive dhe të standardizuar të territorit.

Projektligji propozon konsolidimin e funksioneve të kontrollit dhe inspektimit përmes ngritjes së një strukture të vetme – Inspektoratit Qendror për Territorin, Mjedisin dhe Pyjet – organizuar në nivel qendror, me drejtori rajonale dhe zyra vendore. Ky riorganizim synon rritjen e kapaciteteve inspektuese, profesionalizimin e trupës, rritjen e pavarësisë funksionale si dhe garantimin e një procesi inspektimi të besueshëm, të integritetshëm dhe të mbrojtur nga ndikimet e jashtme. Struktura e re pritet të sigurojë zbatimin e një qasjeje të unifikuar dhe të standardizuar në kontrollin e territorit, në përputhje me objektivat e reformës dhe me kuadrin e ri të inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

Zbatimi i projektligjit pritet të sjellë një sërë efektesh pozitive, ndër të cilat:

- Rritjen e efektivitetit të kontrollit të territorit dhe uljen e ndjeshme të ndërtimeve të kundërligjshme, përmes një strukture të unifikuar, të specializuar dhe të përgjegjshme;
- Standardizimin e praktikave inspektuese në të gjithë territorin, me mekanizma të qartë koordinimi dhe me aftësinë për marrjen e masave të shpejta dhe me rezultate të matshme;
- Krijimin e strukturave të qëndrueshme në nivel qendror dhe rajonal, me personel të trajnuar profesionalisht dhe me optimizim të përdorimit të burimeve njerëzore e financiare;
- Forcimin e koordinimit ndërmjet nivelit qendror dhe atij rajonal, nëpërmjet varësisë së drejtpërdrejtë nga struktura qendrore, duke eliminuar fragmentimin institucional dhe duke rritur koherencën në veprimtarinë inspektuese.

Përmes këtyre ndërhyrjeve, projektligji synon të garantojë një sistem modern dhe të integruar kontrolli të territorit, i cili siguron mbrojtjen e interesit publik, respektimin e ligjit dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të qëndrueshëm në përputhje me standardet europiane të administrimit të territorit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës. Projektligji nuk vjen ndesh me legjislacionin ndërkombëtar.

Projektligji është në harmoni me legjislacionin kombëtar, kryesisht për planifikimin dhe zhvillimin e territorit dhe inspektimet.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar” përbëhet nga 17 nene.

Neni 1 parashikon ndryshime në nenin 3, duke shfuqizuar shkronjën “a” dhe ndryshuar shkronjën “b”, konkretisht duke zëvendësuar Inspektoratin Kombëtar (IKMT) me Strukturën Qendrore për Inspektimin, Inspektorati Qendror i Territorit, Mjedisit dhe Pyjeve.

Neni 2 dhe 3 parashikojnë shfuqizimin e nenit 4 – përgjegjësitë e inspektoriatit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, dhe 5 – detyrat e e inspektoriatit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007,

Neni 4 përcakton ndryshime në nenin 8, duke shfuqizuar kështu pikën 4 dhe bën zëvendësimin terminologjik të togfjalëshit “Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit” me “Inspektorati Qendror i Territorit, Mjedisit dhe Pyjeve” .

Neni 5 shfuqizon referencën ndaj inspektorateve vendore në nenin 8/1.

Në nenin 6, përcakton ndryshim në shkronjën “b” të nenit 9 – Përgjegjësitë e IKMT-së, duke përcaktuar që kontrolli i zbatimit të ligjit bëhet nëpërmjet strukturave qendrore, duke përfshirë ato në nivel rajonal/zyrë vendore.

Neni 7 parashikon ndryshime në Nenin 9/1. Ky nen ripërcakton përgjegjësitë e Inspektoratit Qendror të Territorit, Mjedisit dhe Pyjeve.

Në nenin 8, përcaktohen ndryshimet në nenin 9/2. Ky nen thekson koordinimin e se Inspektorati Qendror i Territorit, Mjedisit dhe Pyjeve me Prefektin Detar. Ky nen integron një entitet të ri - Prefektin Detar. Njëkohësisht me Ligjin Nr.9780/2007, është ndërrmarrë nisma për ndryshimin e Ligjit Për Prefektin, ku integrohet rishtazi Prefekti Detar.

Në nenin 9 parashikohet zëvendësimi i togfjalëshit “në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore”, me togfjalëshin “e Inspektoratit Qendror për Territorit, Mjedisit dhe Pyjet”.

Neni 10 parashikon ndryshimet në nenin 12. Ky nen shfuqizon referencat ndaj Inspektoratit Vendor në procesin e inspektimit dhe përcakton se, Inspektorati Qendror i Territorit, Mjedisit dhe Pyjeve kryen inspektime me grup prej të paktën tre inspektorësh, me shtesa për kontrollin e lejeve të KKTU-së.

Neni 11 përcakton ndryshimet në nenin 13 të ligjit nr. 9780/2007 – dhënia e vendimeve administrative dhe afatet.

Në nenin 12 përcaktohen ndryshimet në nenin 14 të ligjit lidhur me ankimin administrativ ndaj masave të marra nga trupat inspektuese. Ankimet administrative do paraqiten vetëm në Komisionin e Shqyrtimit të Ankimit pranë Inspektoratit të Përgjithshëm, dhe më pas, në gjykatë.

Neni 13, përcakton ndryshim në Nenin 15 duke shfuqizuar togfjalëshin “të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore dhe të inspektorëve”

Nenet 14 dhe 15, me qëllim harmonizimin e terminologjisë, parashikohen ndryshime në Ligjin Nr. 8402/1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht në nenet 7/1, 7/2, 8, 10/1, pikës 3 dhe 6 të nenit 14, dhe Ligjin Nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, në pikat 2 dhe 3 të nenit 53.

Neni 16 parashikon dispozitat kalimtare që sigurojnë vijimësinë e kryerjes së aktivitetit nga strukturat vendore dhe Inspektorati Qendror i Territorit, Mjedisit dhe Pyjeve.

Neni 17 përcakton hyrjen në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e ligjit ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mjedisit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Projektligji i dërgohet për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Mjedisit, Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Departamentit të Administratës Publike, Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe Agjencisë së Zhvillimit të Territorit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji nuk ka efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit pasi strukturat vendore kalojnë në varësi të Inspektoratit Qëndror të Territorit, Mjedisit dhe Pyjeve, si struktura rajonale dhe numëri i punonjësve do të jetë i përafërt me numërin aktual të punonjësve në inspektoriatet e mbrojtjes së territorit të njësive vendore. Në nivel qendror Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit riorganizohet si Inspektoratit Qëndror të Territorit, Mjedisit dhe Pyjeve. Efektet financiare të mundshme do të përballohen nga programi buxhetor afatmesëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

PROPOZUESI

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME

ALBANA KOÇIU